



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

URDHËR

Nr. 65, datë 21.07.2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE
PROCEDURALE NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ELBASAN PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS SË
KUVENDIT DATË 14.06.2021 "PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË PROKURORISË PËR VITIN 2020"**

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 21 dhe 42, shkronja "a" të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.7905, dt.21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale", i ndryshuar, ligjit nr.7895, dt.27.01.1995 "Kodi Penal", i ndryshuar, ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", Rezolutës së dt.14.06.2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020", si dhe Urdhërit nr.78 dt. 09.07.2021 "Për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2020" të Prokurorit të Përgjithshëm:

URDHËROI:

1.Miratimin e Planit të Veprimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 14.06.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020", sipas tekstit bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e masave të Planit të Veprimit ngarkohen Drejtuesit e Seksioneve, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të të gjitha strukturave, Kancelarja, si dhe nëpunësit e prokurorisë në të gjithë nivelet.

3. Në ecurinë e zbatimit të masave të këtij plani veprimi, Drejtuesit e Seksioneve të Prokurorisë shqyrtojnë dhe kujdesen:

i. të ndjekin, koordinojnë dhe monitorojnë në vazhdimësi zbatimin e masave në përputhje me afatet e përcaktuara në planin e veprimit;

ii. të raportojnë për statusin e masave sipas fushës së përgjegjësisë së strukture që drejtojnë;

iii. të ndërhyjnë dhe koordinojnë veprimet kur masat rezultojnë të pazbatuara;

iv. t'i raportojnë Drejtuesit të Prokurorisë me shkrim, qdo muaj, për realizimin e masave dhe/ose aktiviteteteve.

4. Me kërkesë të Drejtuesve të Seksioneve, ose kryesisht, Drejtuesi i Prokurorisë mund të thërrasë mbledhje të drejtuesve apo prokurorëve të Prokurorisë për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të masave të këtij plani veprimi.

5. Drejtuesi i prokurorisë, periodikisht çdo 2 (dy) muaj, dhe sa herë kërkohet, si dhe nëpërmjet raportit vjetor mbi ecurinë e punës së prokurorisë, informon Prokurorin e Përgjithshëm, për masat administrative dhe procedurale të marra për zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit, të shoqëruar me tregues statistikorë të sakte e analitik dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arritjet e problematikat, si dhe me vlerësimin si ka ndikuar zbatimi i kërkesave të rezolutës mbi gjendjen e kriminalitetit dhe performancën e prokurorisë.

6. Me këtë urdhër të njihen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe strukturave hetim ore ne shërbimet e policisë gjyqësore, si dhe nëpunësit e prokurorisë në të gjithë nivelet.

7. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al.

8. Një kopje e këtij urdhëri i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për njoftim dhe publikim në faqen zyrtare.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI



The image shows a large, stylized blue ink signature of Kreshnik Ajazi. Below the signature is a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLICA SHQIPËRISE' at the top, 'PROKURORIA E GJYKES' in the middle, and 'ELBASAN' at the bottom. The center of the stamp features the coat of arms of Albania. The signature and stamp are positioned over the text of the document.

PLAN VEPRIMI

(Për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020”)

Me qëllim për të unifikuar ndjekjen dhe zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021 “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020” në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në kompetencë lëndore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan Elbasan me objektiv përcaktimin e masave administrative dhe procedurale që duhet të merren për realizimin e përparsive që sigurojnë zbatimin hartohet ky plan veprimi.

1. Brenda 5 muajve të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke ju kërkuar prokurorëve që në rastet që ata mund të marrin dijeni nga media apo informacionet që ata mund të administrojnë për shkak të funksionit të tregohen sa më aktivë për fillimin kryesisht të hetimeve.

2. Në vazhdimësi të zhvillohen aktivitete të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese të perfshira, mbi gjurmimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave në bashkëpunim me projektet/ misionet ndërkombetare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale.

3. Në vazhdimësi të forcohen kapacitetet institucionale për rritjen e efijences në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe të veprimtarisë së prokurorëve dhe Policisë Gjyqësore në ushtrimin e funksioneve të tyre, për të shmangur efektet e krijuara nga ulja e numrit të prokurorëve për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke bashkërenduar dhe koordinuar përpjekjet me Keshillim e Lartë të Prokurorisë (KLP) për të planifikuar në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magistrat/prokuror sipas rregullave të percaktuara në ligj, si dhe të kërkohet pranë Prokurorisë së Përgjithshme rritja e numrit të oficerëve të policisë gjyqësore apo punonjësve të administratës sipas rregullave të percaktuara në ligj.

4. Deri në nxjerrjen e një udhezimi të përgjithshëm nga Prokurori i Përgjithshëm “Për përcaktimin e normes/volumit orientues të punës në prokurori”, duke pasur parasysh të dhënat e administruara në “Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale”, ngarkesën e punës në prokurori, mirëfunksionimin e punës në prokurori dhe shpërndatjen e drejtë të çështjeve, mbi bazën e kriterëve transparente të përcaktuara nga Prokurori i Përgjithshëm, numrin dhe specializimin e prokurorëve, përhapjen dhe kategorinë e veprave penale në territorin në juridiksion të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nevojën për konsolidimin e politikës penale, si dhe organikën aktuale dhe faktike të prokurorisë, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, brenda muajit Janar 2022 të bëhet një riorganizim i ri i seksioneve të prokurorisë.

5. Brenda muajit shtator 2021 të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/ose oficerët e Policisë Gjyqësore të kësaj prokurorie lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe më pas të organizohen trajnime të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe prokurorëve duke ia paraqitur këto shqetësime Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shkollës së Magjistraturës për të mundësuar trajtimin e tyre në programet e trajnimeve vazhduese.

6. Në vazhdimësi të kërkohet rritja e trajnimeve në lidhje me ndjekjen penale ndaj grupveprave të trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore, si dhe për mbrojtjen e viktimave dhe në veganti gratë dhe fëmijët.

7. Në vazhdimësi të përmirësohet mbajtja dhe plotësimi me korrektesi i të dhënave statistikore lidhur me viktimat, të miturit dhe të dhënat socio-demografike.

8. Në vazhdimësi të identifikohen problemet dhe të merren masa konkrete për përmirësimin e sistemit menaxhimit të çështjeve” (CAMS), duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e IT-së dhe Drejtorinë Ekonomike dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme.